

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtari Ramiz Azizi, me Zyrtaren Ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehures F. R nga fsh M,K,Gj për shkak të veprës penale “vjedhja e shërbimeve komunale” nga neni 320, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2260/16 e dates 15.12.2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Shefik Memeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 10.05.2017, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

E pandehura F. R. nga fsh.M,K,,Gj, me vendbanim në fshatin,M,K,Gjilanit, nga babai F dhe nëna Q, e lindur K, e lindur me datën ..në Gj, tani me vendbanim në fshatin, e martuar, nanë e katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore , e njehta është shfrytëzues i ndihmës sociale me nr..., i gjendjes së dobët ekonomike,, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penal ndaj saj.

**Është fajtor
Sepse**

Me datë 21.11.2016 në kohë të papërcaktuar nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it është konstatuar se e pandehura, në shtëpinë e saj , me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, pa autorizim ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që , është lidhur direkt , njëhsori elektrik është i dëmtuar , pasi që ka ndërtuar shtëpin të re , me qak me veprimet e saj ka bërë harxhim në mënyrë të pa autorizuar të energjisë elektrike , duke e dëmtuar KEDS-in në shumë prej 114.42 euro.

- me çka ka kryer vepër penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21, 49,50, 51, 52 e 73 të KPRK, si dhe nenit 365,451 e 463 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton :

DËNIM KUMULATIV ME KUSHT

Të akuzuarës, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve si dhe dënim prej 200 (dyqind) Euro të cilin ajo nuk do t'a mbajë gjegjësisht ta paguajë, nëse në afatin prej 1 (një) vit pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Distrikti në Gj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontestin civil.

Shpenzimet e procedurës penale për këtë qështje penalo-juridike, bien në barrë të bugjetit të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurës nga fshati. për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së.

Në fjalën përdundimtare Prokurori i Shtetit Shefik Mehmeti deklaroi :mbes në tërësi pranë aktik akuzues pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësin për veprën penale e cila i vihet në barrë, për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimi të tij. Mbi bazë të këtij pranimi dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozojë gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj me dënim meritator sipas ligjit, i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësis penale, dhe rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i KEDS-it, deklaroi: se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit si dhe i bashkohem ndjekjes penale dhe paraqes kërkesën pasuroro-juridike në shumë prej 114.42 euro.

E akuzuara, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi - se më vije keq për rastin që ka ndodhur dhe më kurr nuk do ta përsëris, dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë, pasi që jam i papune, shfrytëzues i ndihmave sociale me nr.17775 gjendje mjaft të rëndë ekonomike, nanë e katër fëmijëve, dhe hera e parë që ndeshem me ligjin.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike:

Se e pandehura, me dashje eventuale e ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka konstatuar dhe e vërtetoi në bazë të pranimit të fajësisë duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të pandehuren, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehures, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se e pandehura e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit komulativ me burg e gjobë dhe i kushtëzuar, është marr duke u bazuar në të gjitha rrethanat e lartcekura, është dënim i drejtë , në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim komulativ ,do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPK.

Vendimi për pagesën e demit material, është marrë duke u bazuar në nenin 463 të KPRK-së si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 4 të KPPRK-së.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.1477/16 të , dt 10.05.2017

**Zyrtarja Ligjore,
Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.